



REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Numri i Ceshtjes : 52105-00358-30-2013 **Data e Regjistrimit :** 06/03/2013
Numri i Vendimit: 30-2013-3727 **Data e Vendimit :** 18/09/2013

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM E PËRBËRË NGA:

KRYESUES: Ervin Metalla

ANETAR: Evjeni Sinojmeri

SEKRETARE: Iva Ferataj

Sot më datë 18/09/2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Akuzuar: “ Vrasjes me dashje te kryer ne menyre te rrezikshme per jeten e shume personave” me pasoje vdekjen e shtetasit Faik Myrtaj si dhe plagosjen e disa shtetasve te tjere. “ Vrasjes me dashje te kryer ne rrethana te tjera cilesuese, e kryer kunder dy ose me shume personave”, me pasoje vdekjen e shtetasve Hekuran Deda e Ziver Veizaj, si dhe plagosjen e shtetasve Fatos Mahmutaj, Erald Bisha, Sokrat Gode. “ Veprimeve qe pengojne zbulimin e se vertetes”

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim prokuroria, duke parashtruar, ndër të tjera, për të pandehurin Ndrea Prendi:

-Nuk është e vërtetë se prokuroria nuk ka kryer hetime të plota, siç arsyeton gjykata e shkallës së parë;

-Viktimat dhe të plagosurit kanë qenë të paarmatosur, larg rrethimit të godinës së Kryeministrisë, që ishte edhe objekti i sulmit, duke mos kryer asnjë akt dhune;

-Për të provuar dashjen tek i pandehuri Ndrea Prendi, si element i anës subjektive, nuk është e rëndësishme të dihen motivet që e kanë shtyrë për kryerjen e vrasjes;

-Qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë, sipas të cilit gjykata nuk mund të bëjë ndryshim të kualifikimit ligjor të veprës, vjen në kundërshtim me nenin 375 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe me vendimin unifikues nr. 5/2003 të Gjykatës së Lartë.

-Referimi që gjykata e shkallës së parë bën tek vendimi i Gjykatës së Strasburgut me nr. 23458/02, për çështjen Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë, nuk ka asnjë lidhje me rastin për shqyrtim;

-Përdorimi i armëve të zjarrit prej të pandehurve, kundër demonstruesve, është kryer në kundërshtim të hapur me nenin 19, 20, 21 të Kodit Penal, si dhe me nenet 1, 2, 3/b, 5, 7 të ligjit nr. 8290, datë 24/02/1998, “Për përdorimin e armëve të zjarrit”;

-I pandehuri Ndrea Prendi nuk është subjekt i posaçëm, por subjekt i përgjithshëm.

Për të pandehurin Agim Llupo:

-Nuk është e vërtetë që, siç arsyeton gjykata e shkallës së parë, akuza ndaj të pandehurit Agim Llupo bazohet vetëm në dëshminë e disa dëshmitarëve dhe në asnjë provë shkencore;

-Arsyetime të gjykatës së shkallës së parë, sipas së cilës, predha që ka shkaktuar vdekjen e shtetasit Ziver Veizi është e dëmtuar në majë, çka tregon se kjo predhë ka bërë rikoshet para kontaktit me trupin e viktimës, nuk qëndron dhe përbën vetëm një hipotezë të trajektore të predhës, sikur ajo ka hasur në një trup të ngurtë (degë apo trung peme), duke mos gjetur mbështetje në asnjë nga provat shkencore të administruara në gjykim;

-Gjykata e shkallës së parë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 383/1, "ç" të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka arsyetuar pse e ka refuzuar apo konsideruar të papranueshëm aktin e ekspertimit të ekspertit Dritan Zoto, të paraqitur si provë nga akuza;

-Sa i takon dashjes tek i pandehuri Agim Llupo, mungesa e të provuarit të motiveve të vrasjes nuk ndikon në drejtim të cilësimit juridik, pasi motivet nuk janë element i domosdoshëm i anës subjektive të figurës së veprës penale.

Mbrojtja e të pandehurit Ndrea Prendi, në apelin kundërshtues, ndër të tjera, ka parashtruar:

-Komandanti i Gardës së Republikës, i pandehuri Ndrea Prendi në asnjë rast nuk ka qëlluar në drejtim të protestuesve që po sulmonin Kryeministrinë, por vetëm në ajër, madje ka urdhëruar që të mos hapej zjarr ndaj automjetit që tentoi në mënyrë të dhunshme të futej në brendësi të oborrit të Kryeministrisë, gjë që në këto rast do të ishte e plotësisht e bazuar në ligjin për gardën dhe atë për përdorimin e armëve të zjarrit;

-Efektivët e Gardës janë vënë në pozitë të pashmangshme, ligjërisht, për përdorimin e armëve të zjarrit, për shkak të itensitetit të sulmit ndaj Kryeministrisë, gjë që vuri në rrezik iminent jetën e Kryeministrit, Ministrave dhe vetë efektivave të Gardës;

-Gjatë gjithë kohës, kjo është shoqëruar me paralajmërimin me zë të lartë, nëpërmjet altoparlantëve, nga ana e punonjësve të Gardës;

-Të shtënat e efektivave të Gardës kanë qenë gjithnjë paralajmëruese, fillimisht me plumba manovër dhe, më pas, me fishekë luftarakë, por vetëm në mënyrë paralajmëruese, në ajër dhe në asnjë rast në drejtim të turmës;

-Qëllimi i veprimeve të efektivave të Gardës ishte qetësimi i situatës dhe zmbropsja e sulmit të protestuesve me çdo mjet të mundshëm, por pa përdorimin e armëve të zjarrit në mënyrë të drejtpërdrejtë, gjë që provohet me faktin se snajperat nuk kanë qëlluar, si dhe me faktin që nuk u qëllua mbi drejtuesin e mjetit që tentoi të hynte me forcë në brendësi të oborrit të Kryeministrisë, zonë e sigurisë së lartë;

-I vetmi moment kur Garda ka filluar të përdorë në mënyrë të përshkallëzuar mjetet e saj, ka qenë në kohën që protestuesit kanë shpartalluar portën nr. 1 dhe kanë tentuar të futen në brendësi të oborrit;

-Akuza e ngritur ndaj të pandehurit Ndrea Prendi, që parashikohet nga neni 79, gërma "ë", kërkon që ai të ketë dashur të vrasë viktimën Faik Myrtaj, por mënyra si e ka realizuar këtë qëllim kriminal ka vënë në rrezik edhe jetën e personave të tjerë, gjë që nuk ka asnjë bazë, pasi i pandehuri Ndrea Prendi as që e njihte të ndjerin;

-Akuza flet për 11 predha të shtëna nga Komandanti i Gardës, referuar 5 predhave dhe 11 gëzhjojave, por nuk sqaron vendodhjen e 6 predhave të tjera dhe as këndin e predhave, për aq kohë sa distanca me viktimën Faik Myrtaj nuk është përcaktuar dot.

Mbrojtja e të pandehurit Agim Llupo, në apelin kundërshtues, ndër të tjera, ka parashtruar:

-Referimi që bën gjykata e shkallës së parë tek jurisprudenca e GJEDNJ-së qëndron: gardisti Agim Llupo ka perceptuar një rrezik real të jetës së tij dhe të personave të tjerë nga veprimet e dhunshme të turmës, gjë që justifikon përdorimin e armëve të zjarrit, por që, gjithsesi, ai ka qëlluar vetëm në ajër;

-Ndonëse ishte plotësisht i mundur ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale, akuza nuk i është referuar neneve 19, 20 dhe 21 të Kodit Penal dhe, në mungesë të këtij referimi, ka ngritur akuzat që po gjykohen;

-Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë, sipas së cilës nuk provohet se gardisti Agim Llupo ka qëlluar viktimën Hekuran Deda dhe ka plagosur disa të tjerë, është i plotë dhe i argumentuar;

-Dëshmitari Hysni Peposhi tregon se gardisti Agim Llupo mbante armën në këndin 45 gradë, duke realizuar, në mëtë mënyrë, qitje jo të drejtpërdrejtë, siç pretendon akuza;

-Fakti që predha që i mori jetën të ndjerit Ziver Veizi është e deformuar në 1/3 e poshtme të gjatësisë së saj, provon pa asnjë hije dyshimi se trajektorja e saj fillestare ka ndryshuar për shkak se predha ka ndeshur një tjetër objekt që ka devijuar këtë trajektore, pra, rezulton e provuar shkencërisht se nuk bëhet fjalë për qitje të drejtpërdrejtë;

-Prokuroria nuk ka zhvilluar asnjë eksperiment hetimor për të vertetuar pretendimin e saj se qitja ka qenë e drejtpërdrejtë, gjë që do të mund të realizohej duke ballafaquar vendodhjen e gardistit Agim Llupo, me atë të viktimës Ziver Veizi;

-Gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk ka marrë në konsideratë aktin e ekspertimit të ekspertit Dritan Zoto, pasi ai është ekspert grafik dhe jo në fushën e balistikës, si dhe se akti i tij nuk është shkencor e vjen në kundërshtim me konkluzionet shkencore të ekspertëve Ndoc Çardaku e Gani Jahlezi;

-Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i bazuar edhe sa i takon arsyetimit se, përse kohë qitja nuk ishte e drejtpërdrejtë dhe se nuk u provua asnjë motiv për kryerjen e vrasjes, në veprimet e të pandehurit Agim Llupo mungon dashja, si element i anës subjektive të figurës së veprës penale.

Gjykata, pasi dëgjoi relatimin e kryesuesit, prokurorinë që kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 100, datë 07/02/2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe deklarinimin fajtor të pandehurve për akuzat e ngritura, si dhe mbrojtjen e të pandehurve, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë,

VEREN :

II. Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

58. Gjykata e Apelit vlerëson se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është jo plotësisht i bazuar në prova e në ligj dhe, për këtë arsye, ka vend që ai të ndryshohet, në kuptim të nenit 428/b të Kodit të Procedurës Penale. Kështu procedimi penal, siç u parashtrua edhe më lart, ka nisur për shkak të pasojave të ardhura nga qitja me armë zjarri, konkretisht, vdekjes së shtetasve Faik Myrtaj, Ziver Veizi, Hekuran Deda, si edhe plagosjes së shtatë shtetasve të tjerë, Fatos Mahmutaj, Erald Bisha, Sokrat Gode, Artes Dybeli, Ilia Qesko, Ilia Papa dhe Aleks (Aleksandër) Nika, i cili, pas mjekimit paraprak në Spitalin Ushtarak Tiranë, është dërguar për kurim të mëtejshëm në Turqi, ku dhe ka vdekur pas disa ditësh. Kjo ka ndodhur gjatë zhvillimit të tubimit të organizuar nga subjekti politik "Partia Socialiste e Shqipërisë", me datë 21 Janar 2011, në qytetin e Tiranës.

59. Siç ka rezultuar gjatë gjykimit në shkallë të parë, fillimisht, tubimi ka qenë paqësor, por pas njëfarë kohe, për arsye të panjohura, një pjesë e protestueve kanë filluar të kryejnë veprime të dhunshme dhe akte force ndaj efektivave të policisë dhe atyre të Gardës së Republikës, si dhe ndaj objektit të Kryeministrisë. Lidhur me sulmin e protestueve, vetë akuza, në konkluzionet e saj përfundimtare, të

paraqitura pranë gjykatës së shkallës së parë, qëndrim të cilin e mbajti edhe gjatë gjykimit në gjykatën e apelit, argumenton se “aktiviteti i turmës, ka qenë i pakufizuar në kohë e hapësirë, ai ka filluar me dhunën fizike ndaj shërbimeve policore jashtë rrethimit, në pjesën e bulevardit e, mandej, me përdorimin e gurëve, pllakave të trotuarit, deri dhe “bombave molotov” ndaj efektivave të gardës....Efektivat e Gardës, fillimisht në përmbushje të plotë të detyrës, duke konstatuar fillimisht tendencën e, më pas, faktin e depërtimit brenda territorit objekt i mbrojtjes së tyre, të një grupi protestuesish dhe përdorimit të paefektshëm për sprapsjen e tyre të mjeteve policore, të tilla, si, shkopinj gome, mburoja, një pjesë prej tyre kanë qëlluar me armë zjarri, duke përdorur, sipas grupeve dhe vendndodhjeve, fishekë manovër, por edhe fishekë luftarakë” (fq. 12, parg. 2 dhe 3 i pikës 5 të konkluzioneve).

60. Sikurse arsyeton gjykata e shkallës së parë dhe sikurse nuk është kundërshtuar nga palët në atë gjykim, efektivat e Gardës kanë filluar të qëllonin me armë zjarri, me fishekë manovër dhe luftarakë, pikërisht disa minuta pasi kishte kaluar ora 16:00, në kohën që protestuesit, një numër deri në 100 persona, kanë hapur me forcë “Portën nr. 1”, në hyrje të Kryeministrisë, si edhe kanë djegur vendrojnë, duke depërtuar përkohësisht 20-30 metra në brendësi të territorit të rrethuar të Kryeministrisë.

61. Para këtij momenti, efektivat e Gardës kanë paralajmëruar protestuesit për t’u shpërndarë dhe për t’u larguar. Gjithashtu ata janë paralajmëruar edhe për faktin se po hynin në një zonë të sigurisë së veçantë dhe se ndaj tyre do të veprimej sipas ligjit. Kjo është bërë nga komandant Dashmir Shehi, Alfred Ahmetcenaj etj, duke përdorur megafon. Protestuesit fillimisht janë tërhequr, por kanë riprovuar përsëri të futen në brendësi të ORV-së, gjithnjë duke ushtruar forcë, duke goditur efektivat e Gardës, duke i kërcënuar e fyer ata, si edhe duke besuar se qitjet me armë, që kishin rifilluar ndërkohë, ishin me fishekë manovër.

62. Gjithashtu prokuroria në konkluzionet e saj përfundimtare mban qëndrimin se “Është mëse e vërtetuar dhe kjo nuk ka nevojë për asnjë koment se dhuna e ushtruar mbi efektivat e gardës ka qenë thellësisht e egër, e shoqëruar me provokime, me sharje, fyerje, dhunë verbale, për të vazhduar më pas me përdorimin e mjeteve rrethore dhe të përgatitura, të cilat janë përdorur në ato rrethana, me intensitet të pashembullt dhe nga një turmë e madhe njerëzish, pavarësisht përgatitjes fizike dhe paisjeve me mjete mbrojtëse, kanë synuar dhe në fakt kanë realizuar çënimin e integritetit fizik të tyre.....” (pika 5 e konkluzioneve të akuzës, fq 12). Po në këtë pikë të konkluzioneve, akuza mban qëndrimin se, fillimisht, efektivat e gardës, në përmbushje të plotë të detyrës, kanë qëlluar me armë zjarri, me fishekë manovër dhe luftarakë.

63. Gjykata e shkallës së parë me të drejtë arsyeton se jo vetëm KEDNJ-ja, por edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së janë pjesë e rendit të brendshëm juridik, përse kohë me Kushtetutën e vitit 1998 u kalua nga sistemi dualist, sa i takon vendit të së drejtës ndërkombëtare në rendin juridik kombëtar, në sistemin monist. Sipas këtij të fundit, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, siç është edhe KEDNJ-ja, janë pjesë e rendit të brendshëm juridik dhe, për aq sa është e mundur, zbatohen drejtpërdrejtë. Kjo gjë reflektohet edhe në nenin 116 të Kushtetutës së Shqipërisë, i cili parashikon hierarkinë e normave në vend.

64. Po kështu në nenin 21 të Kushtetutës thuhet se “Jeta e personit mbrohet me ligj”, ndërsa në nenin 2 të KEDNJ-së gjenden edhe përjashtimet ose rastet se kur kjo e drejtë mund të kufizohet. Më konkretisht, privimi nga jeta, sipas kësaj dispozite, nuk konsiderohet se shkaktohet në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ky privim vjen nga përdorimi i forcës, që është jo më shumë se absolutisht i domosdoshëm, në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme ose për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.

65. Lidhur me dinamikën e zbatimit të këtij neni, në Vendimin e GJEDNJ-së të datës 27 Shtator 1995, mbi kërkesën nr. 18984/91, që i përket çështjes McCann dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, ndër të tjera, thuhet se teksti i nenit 2 i marrë si i tërë tregon se paragrafi 2 nuk përcakton thjesht situatat në të cilat lejohet vrasja me qëllim, por përshkruan ato kur është e mundur “të përdorësh forcën”, gjë që mund të çojë në vrasjen e tjetrit, qoftë edhe në mënyrë të paqëllimtë. Përdorimi i forcës duhet të jetë “i nevojshëm në mënyrë absolute”.

66. Megjithatë, duke iu referuar edhe nenit 17/1 të Kushtetutës së Shqipërisë, kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore, siç është edhe e drejta e jetës, mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, si dhe duhet të jenë në përpjestim me gjendjen që ka diktuar kufizimin.

67. Lidhur me përdorimin e forcës, pra, të armëve të zjarrit në rastin për gjykim, edhe akuza, me përjashtim të rastit të pasojave, ka mbajtur qëndrimin se ai ka qenë i ligjshëm, për aq sa nevojitej për ndalimin e dhunës dhe sprapsjen e turmës që ushtroi dhunë dhe tentoi të hynte në Kryeministri. Kështu vetë akuza, në konkluzionet përfundimtare të saj, para gjykatës së shkallës së parë, shprehet se “...një sasi fishekësh, e cila ka qenë krahasimisht e njëjtë, por në mënyrë cilësisht të dallueshme nga efektivat e tjerë të gardës, të cilët kanë qëlluar me armët e tyre të zjarrit, por pa u provuar që ata të kenë sjellë pasoja...” (fq. 33 e konkluzioneve).

68. Në këtë aspekt, ka rëndësi analizimi i situatës ligjore aktuale, që ka lidhje me tubimet dhe përdorimin e armëve të zjarrit nga Garda e Republikës. Në ligjin nr. 8773, datë 23/04/2001, “Për tubimet”, në nenin 3/1 të tij parashikohet se “Policia e Shtetit garanton dhe mbron të drejtën e çdo personi për të organizuar dhe marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë. Ndalimi ose shpërndarja e një tubimi lejohet vetëm në rastet e parashikuara në këtë ligj.”. Nga kjo dispozitë del se tubimi duhet të jetë paqësor dhe se autoritetet vendosin shpërndarjen e tij vetëm në rastet e parashikuara në ligj. Në fakt, siç ka rezultuar edhe gjatë gjykimit në shkallë të parë, në një moment të caktuar dhe për një pjesë të protestuesve, tubimi nuk ka qenë paqësor, por i shoqëruar me akte dhune ndaj efektivave të Gardës së Republikës, Policisë së Shtetit dhe Kryeministrisë.

69. Në nenin 9 të po këtij ligji parashikohet si kufizim i së drejtës së tubimit, që passjell shpërndarjen e tij, pikërisht rasti kur mënyra e zhvillimit të një tubimi në një shesh ose vendkalim publik është e tillë që mund të dëmtojë në mënyrë konkrete rendin publik dhe sigurinë e personave apo kur gjatë zhvillimit të tij kryhen krime. Dhe në të vërtetë, siç ka rezultuar edhe gjatë gjykimit në shkallë të parë, autoritetet e Gardës i kanë bërë thirrje protestuesve që të shpërndahen, pasi nga precipitimet e dhunshme të tubimit u rrezikua dhe u dëmtua rendi publik, siguria e efektivave të Gardës, si dhe objekti i rëndësisë së veçantë, Kryeministria. Është fakt i njohur tashmë dënimi i një numri të konsiderueshëm protestuesish për kryerjen e veprave të ndryshme penale, kundër punonjësve dhe pronës publike, pikërisht për këto episode.

70. Në nenin 25 të Ligji nr.8869, datë 22.5.2003, "Për Gardën në Republikën e Shqipërisë", parashikohet se "Punonjësi i Gardës përdor armën në rastet e përcaktuara në ligjin nr.8290, datë 24.2.1998 "Për përdorimin e armëve të zjarrit", si dhe në rastet kur sulmohen: a) personalitetet e larta shtetërore të vendit dhe të huaja dhe b) rojet dhe objektet në ruajtje."

71. Në nenin 3 të ligjit me nr. 8290, datë 24.2.1998, "Për përdorimin e armëve të zjarrit", parashikohet se :

"Forcat e Armatosura dhe ato që nuk bëjnë pjesë në to, por në bazë të ligjeve janë të pajisura organikisht me armë zjarri për kryerjen e detyrave të tyre, i përdorin armët e zjarrit sidomos në këto rrethana:

Nga forcat e policisë së Ministrisë së Brendshme:

.....
b) Ato të policisë së ruajtjes së rendit

- Kur forcat e ruajtjes së rendit ose të tretë, si dhe objektet e tyre, sulmohen me armë a mjete të tjera të rrezikshme për jetën dhe në rrethanat konkrete sulmi nuk mund të zbrapset me mjete të tjera.

3. Nga rojat civilë të armatosur.

- Kur persona të ndryshëm përpiqen të futen forcërisht ose me automjete në zona të ndaluara a në objekte të rëndësisë së veçantë, të caktuara me akte nënligjore ose në objekte që janë marrë në ruajtje."

72. Kjo dispozitë nuk është shteruese, por ka karakter indikativ, pasi shpjegon se cilat janë rrethanat e mundshme të përdorimit të armëve të zjarrit, por pa i kufizuar ato. Rezulton e provuar gjatë gjykimit në shkallë të parë se një numër protestuesish, siç u parashtrua më lart tek rrethanat e çështjes, kanë sulmuar efektivat e policisë si edhe ato të gardës me mjete të rrezikshme për jetën e shëndetit, si dhe janë përpjekur të futen në një objekt të rëndësisë së veçantë, siç ishte Kryeministria.

73. Në nenin 7, po të ligjit për përdorimin e armëve të zjarrit, parashikohet se: "Para përdorimit të armëve të zjarrit, personat, ndaj të cilëve ato do të përdoren, duhet të paralajmërohen me zë të lartë e të qartë.

Kur personi nuk i bindet urdhrorit, por përpiqet të largohet ose të reagojë qëllohet pa paralajmërim duke synuar në pjesët e poshtme të trupit. Kur rrethanat nuk lejojnë në asnjë mënyrë zbatimin e rregullave të mësipërme, armët e zjarrit përdoren pa paralajmërim."

74. Ka rezultuar e provuar se protestuesit e dhunshëm janë paralajmëruar që të shpërndahen, por ata nuk janë bindur. Është shpërthyer me forcë "Porta nr.1", në hyrje të Kryeministrisë, është shkatërruar e djegur vendroja, si dhe është tentuar, së paku dy herë, të hyhet me forcë në brendësi të ORV-së. Efektivat e Gardës kanë qëlluar me armë zjarri në ajër, në mënyrë të përshkallëzuar, pas përdorimit të mjeteve dhe mënyrave të tjera për ndalimin e protestuesve dhe vetëm pas orës pas orës 16:00. Pra, disa orë pas fillimit të veprimeve të dhunshme, në momentin që u shpërthye "Porta nr.1" dhe vendroja, si dhe në kohën kur protestuesit kanë vazhduar të avancojnë duke menduar se qëllohej me fishekë manovër. Efektivat e Gardës, pas paralajmërimit dhe mosbindjes së protestuesve, nuk kanë qëlluar, as duke synuar pjesët e poshtme të trupit të protestuesve dhe as drejtpërdrejtë mbi ta, por në ajër.

75. Kjo provohet jo vetëm nga dëshmitë e dëshmitarëve në seancë gjyqësore, por edhe nga fakti se, po të ishte qëlluar drejtpërdrejt, referuar edhe numrit të madh të gëzhojave të gjetura e sekuestruara në vendngjarje, mbi 500 të tilla, gjë që tregon se është qitur një numër i madh predhash, do të kishte shumë pasoja fatale tek protestuesit që kishin depërtuar në brendësi të territorit të Kryeministrisë. Po kështu, as snajperat të vendosur në lartësi të godinës së Kryeministrisë, nuk kanë qëlluar mbi protestuesit. Lidhur me gjurmët e kalimit të predhave në kangjellat e rrethimit të Kryeministrisë, për të cilat prokuroria pretendon se tregojnë se drejtimi i qitjes nuk ka qenë në çdo rast në ajër, nuk u provua që këto gjurmë të jenë lënë nga kalimi i predhave të qitura nga të pandehurit Ndreja Prendi dhe Agim Llupo.

76. Viktimat Faik Myrtaj, Ziver Veizi, Hekuran Deda dhe Aleks Nika, si edhe të plagosurit, është provuar se nuk kanë qenë pjesë aktive e sulmit, sëbashku me protestuesit e tjerë që kanë qenë aktivë në veprimet e tyre për goditjen e efektivave të Gardës dhe të Policisë, si dhe për tentativat e tyre për hyrjen me forcë në ORV. Ata kanë qenë pasivë, të paarmatosur, jashtë rrethimit të Kryeministrisë, relativisht jo afër ORV-së, duke mos kryer asnjë akt force apo dhune. Kështu viktimat Faik Myrtaj, në momentin e vrasjes, ka qenë 5-6 metra nga trotuari i Gjykatës Kushtetuese, larg Kryeministrisë, ndërsa viktimat Ziver Veizi ka qenë disa metra larg portës kryesore hyrëse të Kryeministrisë, duke qëndruar pasiv.

77. Gjykata e apelit e vlerëson të bazuar në prova e në ligj konkluzionin e gjykatës së shkallës së parë se është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë në rastin e viktimave Ziver Veizi dhe Faik Myrtaj, por jo ajo në rastin e viktimës Hekuran Deda dhe shtetasve që janë plagosur. Kështu është provuar se predha e dalë nga arma e të pandehurit Ndreja Prendi ka shkaktuar vdekjen e të ndjerit Faik Myrtaj, ndërsa predha e dalë nga arma e të pandehurit Agim Llupo ka shkaktuar vdekjen e të ndjerit Ziver Veizi.

78. Akuza ka pretenduar se provohet se i pandehuri Agim Llupo ka qëlluar edhe të ndjerin Hekuran Deda dhe disa shtetas të tjerë që janë plagosur, ndonëse nuk është gjetur predha që ka shkaktuar vdekjen e të ndjerit Hekuran Deda dhe as predhat që kanë shkaktuar plagosjen e shtetasve Fatos Mahmutaj, Erald Bisha, Sokrat Gode, Artes Dybeli, Ilia Qesko, Ilia Papa dhe Aleks (Aleksandër) Nika, i cili më pas ka gjetur vdekjen. Gjetja e këtyre predhave do të bënte të mundur kryerjen e ekspertimit për të përcaktuar se nga cilat armë ishin qitur, gjë që do të provonte lidhjen shkakësore të drejtpërdrejtë, tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

79. Akuza ka pretenduar se kjo provohet nga dëshmitë e dëshmitarëve, si dhe nga pamjet filmike dhe ato të regjistruara nga celulari i dëshmitarit Hysni Peposhi, një pjesë e të cilave janë printuar në formën e fotove në seri, në mënyrë të njëpasnjëshme. Ndonëse këto prova të akuzës mund të kenë shërbyer si bazë për ngritjen e akuzës, nuk provojnë tej çdo dyshimi të arsyeshëm faktin e pretenduar, pra, atë sipas të cilit vdekja e të ndjerit Hekuran Deda dhe plagosja e të tjerëve është shkaktuar nga predhat e qitura nga arma e të pandehurit Agim Llupo

80. Aq më tepër e vërtetë është kjo, nëse mbahet në konsideratë fakti se në kohën që ka qëlluar i pandehuri Agim Llupo, njëkohësisht mund të kenë qenë duke qëlluar edhe efektivë të tjerë të Gardës. Kjo pasi numri i efektivave të Gardës, që kanë qëlluar është i madh dhe numri i predhave që qitura po ashtu, referuar këtu edhe gëzhojave të gjetura në vendngjarje. Shtu këtu edhe faktin se intervali se kur është qëlluar me armë nga gardistët ka qenë pothuaj i njëjtë për të gjithë.

81. Po kështu, është objektivisht e kundërshtueshme saktësia e konstatimit të drejtimit të qitjes me sy të lirë nga dëshmitarët, apo nëpërmjet fotove a filmimeve, në situatën kaotike që ishte krijuar dhe ku kishte shumë njerëz që ishin të përfshirë në veprime nga më të ndryshmet. Kështu dëshmitari Hysni Peposhi ka dëshmuar se ka perceptuar se këndi i qitjes së armës së të pandehurit Agim Llupo ishte 45 gradë, ndërkohë që dëshmitarë të tjerë, kryesisht gardistë, kanë dëshmuar se përgjithsisht këndi ishte 70-75 gradë.

82. Gjykata e apelit konsideron gjithashtu të bazuar në ligj qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, sa i takon detyrimin për të provuar motivet kur pretendohet se vrasja është kryer me dashje direkte. Motivet nuk do të kishin rëndësi në rastin kur forma e fajësisë do të ishte me dashje indirekte ose nga pakujdesia. Kjo është edhe fryma e dispozitave që parashikojnë grupin e veprave penale të vrasjes me dashje, aq më tepër në rrethana cilësuese. Kështu një i pandehur do të mbajë përgjegjësi sipas nenit 79 nëse e vret kallëzuesin e veprës penale, duke e ditur që është kallëzues apo deputetin duke e ditur se është i tillë. Vetëm një person i papërgjegjshëm nga ana mendore, pra, i papërgjegjshëm para ligjit mund të kryejë një vrasje me dashje direkte pa pasur asnjë motiv.

84. Në rastin e vrasjes në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave, parashikuar nga neni 79, gërma “ë”, i Kodit Penal, ligji ka parasysh vrasjen me dashje direkte, të paramenduar ose jo, por rrethana që e bën të cilësuar veprën është mënyra, pra, fakti që autori e realizon qëllimin e tij kriminal duke rrezikuar edhe jetën e personave të tjerë.

85. I pandehuri Ndreja Prendi, në cilësinë e komandantit të Gardës, është provuar se ka qëlluar 11 predha, nga të cilat, veç predhës që i ka shkaktuar vdekjen të ndjerit Faik Myrtaj, janë gjetur edhe katër të tjera, në lartësi që përputhen me deklaratimet e dëshmitarëve për qitje në ajër, si dhe me vetë pretendimin e të pandehurit. Distanca e qitjes ndërmjet të pandehurit Ndreja Prendi dhe viktimës Faik Myrtaj nuk është përcaktuar saktësisht, por ka qenë relativisht jo e vogël, pasi, ndërsa i pandehuri ishte në brendësi të territorit të Kryeministrit, viktima ishte 5-6 metra nga trotuari i Gjykatës Kushtetuese. Duke mbajtur parasysh këtë fakt, si dhe atë se i pandehuri Ndreja Prendi ka qëlluar me pistoletë, por edhe rrethanave të tjera, siç është ana subjektive e të pandehurit, të përshkruara në këtë vendim, nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se trajektorja e predhës së qitur nga i pandehuri Ndreja Prendi ka qenë e drejtpërdrejtë me viktimën Faik Myrtaj, pavarësisht pamundësisë për të përcaktuar trajektorën e saktë apo të faktorëve që mund të kenë ndikuar në këtë trajektore.

86. Gjithashtu nuk është provuar se pse i pandehuri Ndreja Prendi ka dashur të vrasë pikërisht viktimën Faik Myrtaj, ndërkohë që nuk kishte asnjë njohje dhe as ndonjë motiv për këtë gjë. Kjo, ndër të tjera, edhe për faktin se viktima Faik Myrtaj nuk ishte as pjesë aktive e sulmit, gjë që do të mund të shërbente, eventualisht, si motiv për të qëlluar drejtpërdrejtë. Vetë akuza, në parashkrimet e saj para gjykatës së apelit, ashtu sikurse është provuar edhe gjatë gjykimit në shkallë të parë, shprehet se viktima Faik Myrtaj, në momentin që është goditur nga predha vdekjeprurëse, ndodhej 5-6 metra nga trotuari i Gjykatës Kushtetuese, në një distancë të largët nga Kryeministria.

87. Në këto rrethana, prokuroria, praktikisht, pretendon se i pandehuri Ndreja Prendi, jo me pushkë automatike dhe as duke vepruar si snajper, ka marrë shenjë me pistoletë viktimën Faik Myrtaj, që nga larg, duke e goditur dhe duke i shkaktuar vdekjen. Një arsye tjetër që mund të mbahet në konsideratë në këtë aspekt është edhe fakti se i pandehuri Ndreja Prendi ishte eprori më i lartë i Gardës, që mund të urdhëronte këdo nga efektivat për të qëlluar drejtpërdrejtë në atë situatë. Gjithë sa më lart, përjashton dashjen si formë fajësie në veprimet e të pandehurit Ndreja Prendi.

88. Nisur nga sa më lart, me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka përjashtuar mundësinë që i pandehuri Ndreja Prendi të ketë qëlluar drejtpërdrejtë, me dashje direkte, për të vrrarë viktimën Faik Myrtaj. Nuk është bërë e mundur të përcaktohet saktësisht trajektorja e predhës së qitur nga arma e të pandehurit Ndreja Prendi, por gjithsesi nuk provohet ana subjektive e figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri Ndreja Prendi, që është dashja në vrasjen e viktimës Faik Myrtaj. Këtu gjykata e gjen me vend të theksojë se fakti i ndërrimit të tytës së armës së përdorur nga Ndreja Prendi, pas ngjarjes, nuk mundet që në mënyrë prapavepruese të ndikojë në formën e fajësisë së tij në kryerjen e veprimeve dhe sjelljen gjatë ngjarjes.

89. Po kështu, edhe në rastin e të pandehurit Agim Llupo, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka përjashtuar dashjen si formë fajësie në veprimet e tij. Edhe në rastin e kësaj akuze, kërkohet që i pandehuri të ketë dashur në mënyrë direkte të vrasë dy ose më shumë persona, për motive të caktuara, ndërkohë që i pandehuri Agim Llupo as që e njihte viktimën Ziver Veizi. Gjithashtu ky i fundit nuk ishte as pjesë aktive e sulmit ndaj gardistëve dha as ndonjëri nga protestuesit që tentoi të hynte me forcë në brendësi të ORV-së. Nëse do të kishte ndodhur kështu, vrasja do të kishte qenë me dashje direkte dhe do të ishte në diskutim nëse ishte kryer në përmbushje të një detyre të ligjshme ose jo.

90. Lidhur me qëndrimin e ekspertëve Ndoc Çardaku dhe Dritan Zoto, palët ndahen sa i takon faktit nëse predha që ka përshkuar viktimën është qitur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo, para kontakti me trupin e viktimës, ka hasur në një trup të ngurtë, trung peme, që i ka devijuar trajektorën, duke goditur viktimën Ziver Veizi. Eksperti Ndoc Çardaku ka shpjeguar pikërisht variantin e dytë si më të mundshmin, ndërsa eksperti Dritan Zoto ka përjashtuar këtë mundësi.

91. Sipas ekspertit Dritan Zoto, copat e drunjta që u gjetën në vrimën e hyrjes se predhës tek viktima Ziver Veizi, nuk ka mundësi të gjendeshin aty, pasi, eventualisht, do të mund të kishin ngelur tek xhupi apo trikoja e të ndjerit, tesha që ndodheshin të veshura mbi kësmishë. Gjithashtu në këtë argumentim, eksperti Dritan Zoto shton edhe problematikën e konstatuar prej tij gjatë kqyrjes e marrjes së këtyre provave, proces i filmuar, i cili mund të ketë kontaminuar me copat e drunjta këmishën e viktimës.

92. Ndonëse procesverbali i kqyrjes dhe marrjes së këtyre provave, proces i filmuar, ku është bazuar eksperti Ndoc Çardaku, nuk është kundërshtuar nga prokuroria, gjatë gjykimit në shkallë të parë, si i papërdorshëm si provë, gjykata e shkallës së parë, duke i dëgjuar të dy ekspertët dhe pa refuzuar asnjërin prej tyre, si dhe duke mos i dhënë vlerë të paracaktuar ndonjërit, në kuptim të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, është bindur se më i besueshëm është varianti i dhënë nga eksperti Ndoc Çardaku.

93. Pavarësisht mendimeve të ndryshme të ekspertëve, i kuptueshëm në raste të tilla të ndërlikuar, gjykata e apelit vlerëson se mendimi i tyre duhet analizuar në harmoni me provat e tjera. Kështu që të dy ekspertët bien dakort se predha e gjetur tek viktima Ziver Veizi është e dëmtuar, madje asnjëri prej tyre nuk e përjashton mundësinë teorike, sipas së cilës predha mund të godasë një objekt, të marrë material nga kontakti, i cili mund të shoqërojë predhën në flurudhën e saj, deri në vrimën e hyrjes. Edhe eksperti Gani Jalezi shpjegon të njëjtën gjë, duke argumentuar se goditja e predhës i jep materialit të kontaktit, i cili shpëputet, energji kinetike, gjë që bën që të shoqërojë predhën

në flurudhën e saj.

94. Nëse eksperti Ndoc Çardaku ka bindjen se kështu ka ndodhur, eksperti Dritan Zoto e përjashton kategorikisht këtë mundësi, nisur nga argumentat e lartpërmendura, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me copat e drunjtja të gjendura në vrimën e hyrjes së viktimës. Në vlerësimin e kësaj gjykate, edhe nëse përjashtohet mundësia që predha të ketë marrë material nga kontakti që ka hasur para goditjes së viktimës, mbetet fakt i pakundërshtuar se predha është e dëmtuar. Nëse eksperti Ndoc Çardaku është i bindur se dëmtimi ka ndodhur për shkak të përplasjes së predhës me një trung peme, para hyrjes në trupin e viktimës, eksperti Dritan Zoto shpjegon se ka mundësi që kjo të ketë ndodhur për shkak se predha ka ndeshur një kockë të fortë të viktimës, gjatë lëvizjes brenda në trupin e tij.

95. Fakti që predha është e dëmtuar dhe dëshmitarët kanë shpjeguar se qëllon në ajër, si dhe fakti që një pjesë e madhe e dëshmitarëve, në radhët e gardistëve dhe protestuesve, kanë dëshmuar se, në kohën e krismave, kanë parë një numër të madh degësh të pemëve para Kryeministrisë që të këputeshin dhe binin përtokë, përjashton mundësinë që predha e qitur nga i pandehuri Agim Llupo të jetë qitur drejtpërdrejtë ndaj të pandehurit Ziver Veizi, pavarësisht pamundësisë për të përcaktuar me saktësi trajektoren apo faktorët që mund të kenë ndikuar në këtë trajektore.

96. Referimi që gjykata e shkallës së parë bën tek vendimi i Gjykatës së Strasburgut me nr. 23458/02, për çështjen Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë, nuk është plotësisht përkatës me rastin për gjykim. Kështu në këtë rast, çështja penale ndaj karabinierit që kreu vrasjen u arkivua gjatë fazës së hetimeve paraprake, për shkak se u vlerësua se ai kishte kryer një vrasje me dashje, por në kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Në vendimin e autoriteteve italiane, veprimtaria e të cilëve ishte objekt shqyrtimi, haset qëndrimi se, edhe pse trajektorja e saktë e goditjes vdekjeprurëse nuk ka qenë e mundur të përcaktohet, gjithsesi bëhet fjalë për vrasje me dashje, pasi M.P nuk kishte qëlluar vetëm për të trembur agresorët e tij, por për të ndaluar dhunën, duke marrë kështu parasysh rrezikun e vrasjes.

97. GJEDNJ-ja nuk konstatoi shkelje të nenit 2 të KEDNJ-së, pasi përdorimi i forcës vdekjeprurëse në këtë rast kishte qenë legjitim dhe proporcional. Megjithatë referenca tek ky vendim ka vlerë për sa i takon elementëve që duhet të analizojë gjykata, për të vlerësuar nëse një rast i caktuar, siç është rasti objekt gjykimi, mbulohet ose jo nga përjashtimet e nenit 2 të KEDNJ-së.

98. Gjykata e apelit vlerëson se përdorimi i forcës nga të pandehurit Ndreja Prendi dhe Agim Llupo, duke qëlluar me armë zjarri në ajër, në rastin e sulmit që iu bë efektive të Gardës dhe objektit të Kryeministrisë, si objekt i rëndësisë së veçantë, me datë 21 Janar 2011, pas paralajmërimeve përkatëse, ishte i bazuar në ligj, por jo proporcional në raport me viktimat Faik Myrtaj dhe Ziver Veizaj, të cilët nuk bënë pjesë tek protestuesit, pjesë aktive e sulmit.

99. Gjykata e Apelit, në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë, çmon se i pandehuri Ndreja Prendi dhe i pandehuri Agim Llupo kishin detyrimin objektiv dhe mundësinë subjektive për të parashikuar se, mënyra se si ata po qëllonin me armë zjarri në ajër, me fishekë luftarakë, mund të sillte pasojat që erdhën në fakt. Fakti që kanë qëlluar në ajër, pra, jo drejt viktimave, nuk i çliron të pandehurit nga përgjegjësia që ata kanë për të qëlluar në këndin dhe mënyrën e duhur në ajër.

100. Është kjo arsyeja pse në nenin 5/2 të ligjit për përdorimin e armëve të zjarrit, në vënde publike, ku ka mbledhje e grumbullime njerëzish dhe vihet në rrezik jeta e të tjerëve, armët e zjarrit mund të përdoren vetëm kundër personave të veçantë që kryejnë vepra të dukshme dhune kundër personit apo pasurisë. Vetëm në këtë rast përdorimi i forcës do të konsiderohej proporcional.

101. Në këtë mënyrë, këta të pandehur kanë vepruar me pakujdesi në formën e neglizhencës dhe duhet të përgjigjen penalisht për veprën penale të vrasjes nga pakujdesia, të parashikuar nga 85 i Kodit Penal. Kjo pasi, referuar nenit 19 të ligjit për Gardën, punonjësit e gardës i nënshtrohen juridiksionit penal të zakonshëm.

102. I pabazuar në ligj është qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë, sipas të cilit ajo nuk mund të bënte ndryshimin e kualifikimit ligjor të veprës penale. Lidhur me çështjen, nëse gjykata mund të bëjë ndryshim të cilësimit juridik të faktit objekt akuze, në Vendimin me nr. 50/99 i Gjykatës Kushtetuese thuhet se: "...e drejta që i njihet gjykatës për t'i dhënë faktit një përcaktim juridik të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori, nuk është veprim antikushtetues. Në këtë rast, gjykata nuk merr kompetencat e prokurorit dhe as kthehet në organ akuze, por vetëm zbaton ligjin, gjë që është detyrë funksionale e saj.

Kuptimi në këtë mënyrë i përmbajtjes së nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale i shërben dhënies së drejtësisë, sepse në të kundërtën ajo do të vepronte në kundërshtim me provat dhe me ligjin. Në rast se gjykata nuk do të bënte një cilësim të drejtë të veprës penale, vendimi i saj do të prishej nga gjykata më e lartë për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Pra, edhe në këtë aspekt, gjykata është e detyruar të bëjë vetë ndryshimin e cilësimit të veprës kur ky është i ndryshëm nga ai i prokurorit.....gjykata nuk është organ akuze, nuk formulon akuzë të re dhe as e ndryshon atë, por mbi bazën e faktit të paraqitur, bën cilësimin e duhur ligjor të veprës, duke i dhënë faktit një përcaktim tjetër. Në këtë rast, gjykata bën një interpretim të ligjit që ajo zbaton dhe që është në kompetencë të saj dhe nuk cenon aspak kompetencat e prokurorit.....".

103. Pra, gjykata nuk mund të ndërtojë një akuzë të re, për një fakt të ri, por të njëjtit fakt, me atë të parashtruar nga prokuroria, gjykata për hir të dhënies së drejtësisë, mund dhe duhet t'i japë përgjigje, qoftë edhe duke ndryshuar cilësimin juridik të figurës së veprës penale. Konkretisht, siç u parashtrua edhe më lart, është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm fakti i vrasjes së shtetasve Faik Myrtaj dhe Ziver Veizi, pra, pasoja e kundërligjshme, si dhe lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë.

104. Ajo që shtrohej para gjykatës së shkallës së parë ishte përcaktimi i faktit nëse kishte kundërligjshmëri në sjelljen dhe veprimet e të pandehurve Ndreja Prendi dhe Agim Llupo. Nëse po, cila ishte forma e fajësisë në këtë rast.

105. Në nenin 85 të Kodit Penal, që parashikon vrasjen nga pakujdesia, thuhet se "Vrasja nga pakujdesia dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet". Lidhur me llojin dhe masën e dënimit gjykata mban parasysh rrezikshmërinë shoqërore të pandehurit Ndreja Prendi, e cila nuk rezulton të jetë shumë e lartë, pasi ai është oficer madhor i Gardës së Republikës, me gradën general, i cili ka vepruar në kushtet e një përgjegjësie të madhe, si eprori më i lartë i Gardës, gjë që ka ndikuar në krijimin e një tronditje të caktuar në kohën e ngjarjes, rrethanë lehtësuese kjo e parashikuar nga eni 48/b e Kodit Penal. Ndërkohë që nuk konstatohet e njëjta situatë tek rasti i të pandehurit Agim Llupo.

Për këto arsye

Baza Ligjore:

Gjykata e Apelit Tiranë, bazuar në nenin të 428/b Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI: Vendosi: Ndryshimin e vendimit nr.100, date 07.02.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si më poshtë:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Ndrea Prendi, për kryerjen e veprës penale të " Vrasje nga pakujdesia", me pasoje vdekjen e shtetasit Faik Myrtaj, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal dhe, bazuar në këto dispozite, denimin e tij me 1 (një) vit burgim.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Agim Llupo, për kryerjen e veprës penale të " Vrasje nga pakujdesia", me pasoje vdekjen e shtetasit Ziver Veizi, parashikuar nga neni 85 i Kodit Penal dhe, bazuar në këto dispozite, denimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.

Lenien në fuqi të vendimit për pjesën tjetër.

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	0
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	0

ANETAR:

Evjeni Sinojmeri

KRYESUES:

Ervin Metalla